

UDHËZIM
Nr.32, datë 24.10.2008

PËR PROCEDURAT E RIMBURSIMIT TË AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE TË KONSUMUARA NË SERRAT ME NGROHJE DHE PRODHIMIN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE DHE AGROINDUSTRIALE, TË CILAT PËRDOREN PËR NEVOJAT TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 2.d, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, si dhe pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1158, datë 13.8.2008 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës të lëndëve djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

UDHËZOJNË:

1. Subjektet të cilat disponojnë serra me ngrohje, si dhe ato subjekte të cilat prodhojnë produkte industriale dhe agroindustriale, u rimburohet vlera e akcizës së lëndëve djegëse (gazoil (diesel), solar, (mazut)) e cila përdoret vetëm për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve, sipas sektorëve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1158, datë 13.8.2008. Përjashtim nga ky rregull bën vetëm lënda djegëse, e cila përdoret në sektorin e prodhimit të çelikut.

2. Personat juridikë, vendas ose të huaj, të cilët konsumojnë lëndë djegëse në serrat me ngrohje, prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, duhet të depozitojnë pranë degës së tatimeve ku janë regjistruar, kartën teknologjike me të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1158, datë 13.8.2008, si dhe të dhëna të tjera, të cilat duhet të konfirmohen (certifikohen) nga një institucion i njohur që ka aftësinë dhe lidhet me proceset teknologjike të produkteve që përdorin këto lëndë djegëse, sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar.

3. Degët e tatimeve, brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga ana e personit juridik që kërkon rimbursimin, kryejnë rimbursimin për një periudhë 3-mujore të akcizës së lëndës djegëse të përdorur, pasi personi të paraqesë pranë tyre:

a) kartën teknologjike, me të dhënat e kërkuara sipas pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave;

b) konfirmimin (certifikimin) e këtyre të dhënave, sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave;

c) faturat tatimore të shitjes së produktit të gatshëm (final) me TVSH.

Mbas verifikimit dhe konfirmimit të rregullsisë së dokumentacionit të kërkuar sa më sipër, inspektori/ët i/e tatimeve kryejnë llogaritjet për rimbursimin e akcizës, bazuar në shtojcën 1: “Tabela referuese e normativave të harxhimit të lëndës djegëse”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave, si dhe në shtojcën 1: “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Në shtojcën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, sasia e lëndës djegëse për njësi të produktit final, llogaritet për mazutin e solarin në kg ndërsa për gazoilin (diesel) në litër. Për proceset teknologjike, sipas aktiviteteve, njësia për produktin final llogaritet në kg, litra ose copë (sipas pikës 2.d të vendimit të Këshillit të Ministrave).

Shembull. Po të marrim aktivitetin “Prodhim tullash dhe tjegullash me pjekje termike etj.”, të shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, është përcaktuar që për 1 kv produkt final nevojiten 4 kg solar. Meqenëse nga personat juridikë prodhues, shitja me faturë tatimore me TVSH, deklarohet në copë, duhet që nga këto subjekte, në faturën tatimore me TVSH, të shënohet dhe sasia në kv, e cila i korrespondon sasisë në copë të produktit.

Kjo shtesë e faturës bëhet për të kryer llogaritjen e rimbursimit të akcizës, sipas shtojcës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1158, datë 13.8.2008.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I BUJQËSISË,
USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË
KONSUMATORIT
Jemin Gjana

MINISTRI I
EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGETIKËS
Genc Ruli